



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë The Bountiful Company nga shoqëria Nexus Holdco, LLC.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.254 prot., i AK, datë 20.05.2021 “Njoftim Përqendrimi i Garantuar”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me marrjen e kontrollit të shoqërisë The Bountiful Company nga shoqëria Nexus Holdco, LLC.

Palët në marrëveshje janë:

Nexus Holdco, LLC, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në shtetin Delaware, një filial indirekt që zotërohet plotësisht nga shoqëria Nestlé S.A.

Nexus Merger Sub, Inc., një shoqëri e regjistruar në shtetin Delaware, degë e drejtpërdrejtë e cila zotërohet plotësisht nga shoqëria Nexus Holdco, LLC.

Nexus Merger Sub, Inc. dhe Nexus Holdco, LLC, janë shoqëri të sapoformuara më qëllim të realizimit të transaksionit të propozuar.

Nestlé S.A është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit zvicerian, me aktivitet; prodhimi, tregtimi dhe shitja e një larmie të madhe të produkteve ushqimore dhe pijeve, përfshirë produktet e bulmetit, kafe, ujë i paketuar, drithëra, ushqime të përgatitura etj.

Grupi Nestlé nuk ka filiale, degë apo zyra përfaqësimi në Shqipëri por realizon të ardhura nëpërmjet shitjeve nga palë të tjera të produkteve të shpërndara të kafesë, ujit, produkte të kulinarisë, bulmet, ëmbëlsira, ushqim për kafshët dhe ushqim për fëmijët.

The Bountiful Company, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të shtetit të New Jersey, me aktivitet; prodhimin, tregtimin dhe furnizimin e vitaminave, mineraleve, suplementeve bimore dhe suplementeve të tjera të specializuara si dhe produkteve të ushqimit aktiv, e cila zotërohet në masën 99.8% të aksioneve nga shoqëria Clover Parent Holdings L.P, një shoqëri komandite, e regjistruar në shtetin Delaware,

Portofoli i Bountiful, aktualisht përfshin marka të tilla si: Nature’s Bounty, Solgar, Pure Protein, Osteo Bi-Flex, Puritan’s Pride, Sundown, Body Fortress, met-Rx, Dr. Organic dhe Ester-C.

Transaksioni i propozuar do të përfshijë vetëm markat e vitaminave, mineraleve dhe suplementeve bimore; Nature’s Bounty, Solgar, Osteo Bi-Flex, Puritan’s Pride, si dhe biznesin e markave private amerikane të shoqërisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.